

**LIGJI NR. 08/L-063**

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJEVE QË KANË TË BËJNË ME RACIONALIZIMIN DHE VENDOSJEN E VIJAVE LLOGARIDHËNËSE TË AGJENCIVE TË PAVARURA**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës:**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJEVE QË KANË TË BËJNË ME RACIONALIZIMIN DHE VENDOSJEN E VIJAVE LLOGARIDHËNËSE TË AGJENCIVE TË PAVARURA**

**KAPITULLI I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi**

1. Ky ligj ka për qëllim të bëjë ndryshimin dhe plotësimin e Ligjeve në vijim për racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura:

- 1.1. Ligjit Nr. 04/L-146 për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës;
- 1.2. Ligjit Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas;
- 1.3. Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë;
- 1.4. Ligji Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil.

**KAPITULLI II  
NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I LIGJIT NR. 04/L-146 PËR AGJENCINË PËR MENAXHIMIN E KOMPLEKSEVE MEMORIALE TË KOSOVËS**

**Neni 2**

Neni 1 i Ligjit bazik, riformulohet si në vijim:

**Neni 1  
Qëllimi**

1. Me këtë ligj, Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës e themeluar me Ligjin bazik, bartet në kuadër të Ministrisë përgjegjëse për kulturë dhe funksionon si Agjenci Ekzekutive në pajtim me Ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.
2. Emërtimi i Agjencisë është Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale.
3. Ky Ligj përcakton detyrat, përgjegjësitë dhe funksionimin e Agjencisë.

### **Neni 3**

Neni 3 i Ligjit bazik, riformulohet si në vijim:

### **Neni 3** **Statusi i nëpunësit të Agjencisë dhe Stema**

1. Nëpunësi i Agjencisë ka statusin e shërbyesit civil.
2. Agjencia ka stemën, e cila përcaktohet me akt nënligjor.

### **Neni 4**

Neni 5 i Ligjit bazik, riformulohet si në vijim:

### **Neni 5** **Drejtori i Agjencisë**

1. Agjencia udhëhiqet nga Drejtori Ekzekutiv i cili është përgjegjës për administrimin, funksionimin dhe menaxhimin e Agjencisë.
2. Drejtori i Agjencisë i emëruar sipas nenit 6 të Ligjit bazik, vazhdon të ushtrojë detyrën deri në përfundim të mandatit.
3. Emërimi, shkarkimi, statusi, mandati dhe kohëzgjatja e mandatit, si dhe elementet tjera të marrëdhënies së punës rregullohen me Ligjin përkatës për Zyrtarët Publikë.
4. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv, përcaktohen me Ligjin bazik, Ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, si dhe me legjislacionin tjetër në fuqi.

### **Neni 5**

Nenet 6, 7, 8, të Ligjit bazik, fshihen.

### **Neni 6**

Neni 9 i Ligjit bazik, riformulohet si në vijim:

### **Neni 9** **Buxheti i Agjencisë**

Agjencia financohet nga buxheti i shtetit dhe është pjesë e buxhetit të Ministrisë përgjegjëse për kulturë. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, buxheti aktual i Agjencisë bëhet pjesë e buxhetit të Ministrisë përgjegjëse për kulturë.

### **Neni 7**

Neni 10 i Ligjit bazik, riformulohet si në vijim:

### **Neni 10** **Paga e Drejtorit të Agjencisë**

Paga e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë është e njëjtë me pagën e pozitës së Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Ekzekutive.

**Neni 8**

Neni 11 i Ligjit bazik, riformulohet si në vijim:

**Neni 11  
Struktura organizative e Agjencisë**

Struktura dhe organizimi i Agjencisë rregullohen në pajtim me Ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.

**Neni 9**

Pas nenit 12 të Ligjit bazik, shtohet neni i ri 12/A si në vijim:

**Neni 12/A  
Dispozitat Kalimtare**

1. Brenda gjashtë (6) muajve, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Ministria përgjegjëse për kulturë bën plotësimin-ndryshimin e Rregullores për organizimin e brendshëm të Agjencisë.
2. Të gjitha kontratat publike të cilat janë lidhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji janë të vlefshme dhe menaxhohen nga Agjencia deri në afatin e përcaktuar për skadimin e tyre.
3. Kontratat publike të cilat janë në procedurë gjatë hyrjes në fuqi të këtij ligji, përfundohen sipas legjislacionit përkatës për Prokurim Publik.
4. Ministria përgjegjëse për kulturë dhe Ministria përgjegjëse për financa bëjnë ndryshimet e nevojshme sipas paragrafit 1 të këtij neni në pajtim me Ligjin përkatës për menaxhimin e financave publike dhe Ligjin për ndarjet buxhetore.

**Neni 10**

Neni 13 i Ligjit bazik riformulohet si në vijim:

**Neni 13  
Aktet nënligjore**

Aktet nënligjore sipas Ligjit bazik, përgatiten dhe harmonizohen nga Ministria përgjegjëse për kulturë brenda gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe miratohen nga Qeveria.

**KAPITULLI III  
NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I LIGJIT NR. 04/L-017 PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS****Neni 11**

Neni 2 i Ligjit bazik riformulohet si në vijim:

**Neni 2  
Fushëveprimi**

Me këtë ligj përcaktohen llojet, shtrirja, shfrytëzuesit dhe ofruesit e ndihmës juridike falas, funksionimi i Agjencisë për ndihmë juridike falas në kuadër të Ministrisë përgjegjëse për drejtësi, kompetencat, procedura dhe kushtet për realizimin e ndihmës juridike falas dhe financimi i ndihmës juridike falas.

## **Neni 12**

Nenet 11, 12, 14, 15, 16, 17, 18, paragrafi 2 i nenit 23 dhe neni 36 të Ligjit bazik fshihen.

## **Neni 13**

Neni 13 i Ligjit bazik riformulohet si në vijim:

### **Neni 13**

#### **Kompetencat e Ministrisë përgjegjëse për drejtësi në ofrimin e ndihmës juridike falas**

1. Kompetencat e Ministrisë janë:

- 1.1. Hartimi i politikave dhe rregullave për ofrimin e ndihmës juridike falas, që sigurojnë sistem efektiv, efikas, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm;
- 1.2. Ushtrimi i mbikëqyrjes së punës dhe funksionimit gjithëpërfshirës të sistemit të ndihmës juridike falas;
- 1.3. Identifikimi i prioriteteve në ofrimin e ndihmës juridike falas në varësi të burimeve dhe mjeteve financiare në dispozicion.

2. Ministria përgjegjëse për drejtësi prezanton raportin për ofrimin e ndihmës juridike falas një (1) herë në vit dhe të njëjtin e publikon në faqen e saj zyrtare.

## **Neni 14**

Neni 19 i Ligjit bazik riformulohet si në vijim:

### **Neni 19**

#### **Themelimi dhe Statusi i Agjencisë**

1. Me këtë ligj themelohet Agjencia Për Ndhimë Juridike Falas (në tekstin e mëtejme Agjencia).
2. Agjencia ka statusin e Agjencisë Ekzekutive në pajtim me Ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.
3. Agjencia është pjesë përbërëse e Ministrisë përgjegjëse për drejtësi.
4. Varësisht nga nevoja dhe në pajtim me Ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, Agjencia krijon degë lokale për ndihmë juridike falas.

## **Neni 15**

Neni 20 dhe 21 i Ligjit bazik riformulohen në një nen të vetëm si në vijim:

### **Neni 20**

#### **Drejtori i Agjencisë**

1. Agjencia udhëhiqet nga Drejtori Ekzekutiv i cili është përgjegjës për administrimin, funksionimin dhe menaxhimin e Agjencisë.
2. Emërimi, shkarkimi, statusi, mandati dhe kohëzgjatja e mandatit, si dhe elementet tjera të marrëdhënies së punës rregullohen me Ligjin përkatës për zyrtarët publikë.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv, përcaktohen me Ligjin bazik, Ligjin përkatës

për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, si dhe me legjislacionin tjetër në fuqi.

4. Paga e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë është e njëjtë me pagën e pozitës së Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Ekzekutive.

#### **Neni 16**

Paragrafët 4 dhe 5 të nenit 22 të Ligjit bazik fshihen.

#### **Neni 17**

Neni 24 i Ligjit bazik fshihet.

#### **Neni 18**

Neni 28 i Ligjit bazik, paragrafi 1, riformulohet si në vijim:

1. Zyrat mobile për ndihmë juridike falas themelohen nga Ministria përgjegjëse për drejtësi me propozim të Agjencisë.

#### **Neni 19**

Neni 30 i Ligjit bazik riformulohet si në vijim:

#### **Neni 30**

#### **Organizatat Jo-Qeveritare**

Organizatat Jo-Qeveritare ofrojnë shërbime juridike të autorizuara, në bazë të kritereve të përcaktuara nga Ministria përgjegjëse për drejtësi, me propozim të Agjencisë.

#### **Neni 20**

Nenet 34 dhe 35 të Ligjit bazik fshihen dhe riformulohen në një nen të vetëm si në vijim:

#### **Neni 34**

#### **Ankesa**

1. Çdo person ka të drejtën që të paraqesë ankesë ndaj çdo vendimi të Agjencisë pranë Komisionit për Ankesa, i cili themelohet nga Ministri me Akt nënligjor dhe funksionon në kuadër të Ministrisë përgjegjëse për drejtësi.

2. Ankesat parashtrohen në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga njoftimi me vendimin e Agjencisë, të cilat adresohen në pajtim me Ligjin përkatës për procedurën e përgjithshme administrative.

3. Komisioni vendos sa më shpejt që është e mundur por jo më gjatë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e pranimit të ankesës.

4. Komisioni për ankesa është organ epror i cili shqyrton ankesat në pajtim me Ligjin përkatës për procedurat e përgjithshme administrative.

#### **Neni 21**

Neni 37 i Ligjit bazik riformulohet si në vijim:

### **Neni 37 Donacionet**

Agjencia mund të pranojë donacione shtesë nga donacionet vendore dhe ndërkombëtare në pajtim me Ligjin përkatës për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

### **Neni 22**

Neni 38 i Ligjit bazik riformulohet si në vijim:

### **Neni 38 Dispozitat Kalimtare**

1. Brenda gjashtë (6) muajve, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Ministria përgjegjëse për drejtësi bën ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin e brendshëm të Agjencisë në pajtim me Ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.

2. Të gjitha kontratat publike të cilat janë lidhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në afatin ligjor për skadimin e tyre.

3. Kontratat publike të cilat janë në procedurë gjatë hyrjes në fuqi të këtij ligji, përfundohen sipas legjislacionit përkatës për Prokurim Publik.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, pushon mandati i anëtarëve të Këshillit.

5. Aktet e mbetura nënligjore sipas Ligjit bazik përgatiten dhe harmonizohen nga Ministria përgjegjëse për drejtësi brenda gjashtë (6) muajve dhe miratohen nga Qeveria.

## **KAPITULLI IV NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I LIGJIT NR. 05/L-095 PËR AKADEMINË E DREJTËSISË**

### **Neni 23**

Paragrafi 3 i nenit 10 i Ligjit bazik fshihet.

### **Neni 24**

Neni 18 i Ligjit bazik riformulohet si në vijim:

### **Neni 18 Emërimi dhe shkarkimi i Drejtorit Ekzekutiv**

1. Emërimi dhe shkarkimi i Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë bëhet nga Këshilli Drejtues në pajtim me dispozitat që rregullojnë pozitat e nivelit të lartë drejtues sipas Ligjit përkatës për zyrtarët publik.

2. Kandidatët të cilët kanë ardhur nga pozita e Gjyqtarit apo Prokurorit, pas përfundimit të mandatit si Drejtor i Akademisë, mund të kthehen për të ushtruar funksionin të cilin e kanë ushtruar para emërimit në këtë pozitë.

### **Neni 25**

Neni 23 i Ligjit bazik riformulohet si në vijim:

**Neni 23**  
**Të punësuarit në Akademi**

Të punësuarit në akademi kanë statusin e nëpunësit civil sipas Ligjit përkatës për zyrtarët publik.

**Neni 26**

Pas nenit 27 të Ligjit bazik shtohet një nen i ri 27/A si në vijim:

**Neni 27/A**  
**Mbikëqyrja e Akademisë**

Mbikëqyrja e Akademisë së Drejtësisë bëhet nga Këshilli Drejtues. Gjatë mbikëqyrjes zbatohen përshtatshmërisht neni 29, 30 dhe 31 i Ligjit Nr. 06/L -113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, që rregullojnë pjesët që kanë të bëjnë me Agjencitë Ekzekutive.

**KAPITULLI V**  
**NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I LIGJIT NR. 03/L-051 PËR AVIACIONIN CIVIL**

**Neni 27**

Paragrafi 3.4 i nenit 3 të Ligjit bazik, riformulohet si në vijim:

3.4. Në kuadër të kompetencave të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 15 të këtij ligji, AAC është e detyruar dhe e autorizuar, që të:

3.4.1. Nxjerrë Akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji, me anë të të cilave bëhet përvetësimi i Standardeve dhe Praktikave të Rekomanduara nga ONAC;

3.4.2. Pavarësisht nga nënparagrafi 3.4.1 i këtij neni, nëse AAC konstaton se ka arsye të mira për të evituar përvetësimin e një standardi të ONAC, atëherë njofton menjëherë ONAC lidhur me ndryshimet ndërmjet Rregulloreve për zbatim dhe Standardeve të ONAC.

**Neni 28**

Neni 6 i Ligjit bazik riformulohet si në vijim:

**Neni 6**  
**Përgjegjësitë themelore të Ministrit dhe Ministrisë.**

1. Ministria është përgjegjëse për:

1.1. Zhvillimin e politikave kombëtare për transportin ajror.

1.2. Organizimin, zbatimin dhe/ose marrjen e masave për zhvillimin e Aviacionit Civil në Kosovë dhe bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e Aviacionit Civil.

1.3. Udhëheqë në zhvillimin e politikave dhe programeve të Aviacionit Civil, si dhe përgatitë rekomandime për shqyrtim dhe miratim nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

1.4. Promovimin, merr përsipër përpilimin, mbledhjen dhe shpërndarjen e të dhënave teknologjike, statistike, ekonomike, si dhe të dhënave të tjera të cilat kanë të bëjnë me Aviacionin Civil.

## **Neni 29**

Në paragrafin 2 të nenit 11 të Ligjit bazik fshihen fjalët: “lëshimin e licencave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit ajror”.

## **Neni 30**

Neni 14 i Ligjit bazik riformulohet si në vijim:

### **Neni 14**

#### **Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës**

1. Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës (“AAC”) i themeluar me Ligjin bazik është përgjegjës për rregullimin e sigurisë së Aviacionit Civil dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe shërbimeve të navigimit ajror në Republikën e Kosovës.

2. AAC ka statusin e Agjencisë rregullatore në pajtim me Ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.

3. AAC vepron në interes të publikut dhe në mënyrë të pavarur ushtron funksionet e përcaktuara në bazë të këtij ligji. Asnjë autoritet apo zyrtar publik nuk ka të drejtë të ndikojë ose të udhëzojë apo këshillojë Drejtorin e Përgjithshëm ose një anëtar të personelit ose konsulent të AAC-së, në lidhje me cilindo vendim ose veprim (masë) të pazgjidhur ose të përfunduar rregullatore apo operacionale të AAC-së, përveç nëse:

3.1. Shprehimisht është përcaktuar ndryshe në këtë ligj;

3.2. Nëse është e nevojshme, në mënyrë që ky autoritet apo zyrtar tjetër publik t'i ushtrojë detyrat e përcaktuara sipas legjislationit në fuqi.

## **Neni 31**

Neni 15 i Ligjit bazik riformulohet si në vijim:

### **Neni 15**

#### **Kompetencat dhe përgjegjësitë e AAC-së**

15.1 AAC është përgjegjës për:

a) Zbatimin e legjislationit mbi aviacionin civil dhe zbatimin e politikave të miratuara nga Ministria ose Qeveria në fushën e Aviacionit Civil;

b) Ofrimin e këshillave dhe propozimeve për Ministrinë, Qeverinë dhe Kuvendin lidhur me politikën dhe legjislationin nga fusha e Aviacionit Civil;

c) Nxjerrjen e rregullave të zbatimit dhe urdhërave për siguri të navigimit ajror, në përputhje me Ligjin bazik dhe Marrëveshjen HPEA, me qëllim të zbatimit të politikave të Aviacionit Civil të Ministrisë dhe legjislationit përkatës nga fusha e Aviacionit Civil;

d) Lëshimin e Licencave, Certifikatave dhe Lejeve në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e AAC-së;

e) Rregullimin e sigurisë së transportit ajror në Republikën e Kosovës;

f) Rregullimin ekonomik të tregut të aeroporteve dhe shërbimeve të navigimit ajror;

g) Ofrimin e këshillave për Ministrinë në lidhje me përgatitjen e propozim-politikave mbi



shfrytëzimin e hapësirës ajrore të Kosovës të cilat i përmbushin nevojat e shfrytëzuesve, duke pasur parasysh sigurinë kombëtare, faktorët ekonomik dhe mjedisor, nevojën për standarde të larta të sigurisë;

h) Mbikëqyrjen dhe sigurimin e zbatimit në mënyrë efektive të legjislacionit, standardeve, rregullave, procedurave dhe urdhërave të aviacionit civil, përveç, kur me Ligjin bazik ose me një Akt tjetër juridik, ky funksion shprehimisht i është dhënë Ministrisë ose një autoriteti tjetër publik;

i) Shpërndarjen e informatave për publikun rreth çështjeve relevante mbi funksionet dhe aktivitetet e AAC;

j) Në përputhje me dispozitat dhe qëllimin e Ligjit bazik, marrjen e masave, kryerjen e hetimeve, inspektimeve dhe nxjerrjen e urdhërave, rregullave, Rregulloreve dhe/ose procedurave të cilat AAC me arsye i konsideron të nevojshme për: (i) zbatimin e rregullt dhe të ligjshëm të dispozitave të Ligjit bazik ose (ii) ushtrimin e rregullt dhe të ligjshëm të kompetencave dhe detyrave të cilat i janë dhënë AAC me Ligjin bazik;

k) Ushtrimin e funksioneve të tjera të cilat kanë të bëjnë me Aviacionin Civil në Kosovë, që janë dhënë sipas Ligjit bazik ose legjislacionit tjetër në fuqi.

### **Neni 32**

Nenet 16, 17, 18 dhe 19 të Ligjit bazik fshihen.

### **Neni 33**

Neni 20 i Ligjit bazik riformulohet si në vijim:

#### **Neni 20 Drejtori i AAC-së**

1. AAC udhëhiqet nga Drejtori i AAC-së, i cili zgjedhet në pajtim me nenin 24 të Ligjit përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.
2. Drejtori i AAC-së, emërohet nga Qeveria.
3. Kandidati për drejtor të AAC-së, duhet t'i plotësojë kriteret e përcaktuara për Sekretar të Përgjithshëm sipas legjislacionit në fuqi për zyrtarët publikë.
4. Procesi i rekrutimit të drejtorit të AAC-së, zhvillohet nga Komisioni Shtetëror i Pranimit për pozitat e larta drejtuese të nëpunësve civilë.
5. Drejtori i Agjencisë i emëruar sipas nenit 20 të Ligjit bazik, vazhdon të ushtrojë detyrën deri në përfundim të mandatit.

### **Neni 34**

Neni 22 i Ligjit bazik fshihet.

### **Neni 35**

Paragrafi 1 i nenit 24 të Ligjit bazik riformulohet si në vijim:

1. Përgjatimisht të punësuarve sipas paragrafit 3 të nenit 24 të Ligjit bazik, të punësuarit tjerë në Agjenci, kanë statusin e nëpunësit civilë dhe marrëdhënia e tyre të punës, rregullohet me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publikë.

### **Neni 36**

Neni 25 i Ligjit bazik riformulohet si në vijim:

#### **Neni 25 Buxheti i AAC-së**

25.1. Autoriteti i Aviacionit Civil financohet nga buxheti i shtetit, AAC ka të hyra nga:

- a) Taksat të cilat ndërlidhen me aviacionin, detyrimet dhe tarifat;
- b) Një përqindje nga shërbimet e navigimit ajror që ofrohen brenda hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës;
- c) Tarifat për sigurinë e pasagjerëve dhe tarifat e certifikimit dhe licencimit;
- d) Donacionet, grandet dhe përkrahjet (mbështetjet) tjera financiare ose teknike të caktuara për AAC në.

25.2 Për çdo vit fiskal, Drejtori i AAC-së, përgatitë propozim-buxhetin dhe kërkesën për përvetësime të AAC-së, të cilat i dorëzon në Qeveri. Propozim-buxheti bëhet në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, si dhe me Planin e Punës dhe Financiar në përputhje me nivelin aktual të pritshëm të hyrave të AAC-së.

### **Neni 37**

Neni 26 i Ligjit bazik riformulohet si në vijim:

#### **Neni 26 Llogaridhënia dhe Mbikëqyrja e AAC**

Mbikëqyrja e performancës dhe veprimtarisë së AAC-së, është përgjegjësi e Qeverisë së Kosovës, e cila ushtrohet nëpërmjet Ministrit përgjegjës për transport në pajtim me Ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.

### **Neni 38**

Neni 34 i Ligjit bazik riformulohet si në vijim:

#### **Neni 34 Detyrimi për marrjen dhe posedimin e Licencës për Ushtrimin e Veprimtarinë së Transportit Ajror**

Çdo person i cili posedon një COA të lëshuar nga AAC, i cili dëshiron të angazhohet në transportimin ajror të personave, bagazhit, ngarkesës dhe/ose postës në këmbim me kompensim, qira ose shpërblim, duhet të marrë dhe të ketë në posedim një Licencë për Ushtrimin e Veprimtarisë së Transportit Ajror aktuale dhe të vlefshme, të lëshuar nga AAC. AAC lëshon një licencë të këtillë në përputhje me Rregulloren e Këshillit të Evropës mbi rregullat e përbashkëta për operimin e shërbimeve ajrore.

### **Neni 39**

Në tërë tekstin e nenit 36 të ligjit bazik, emërtesa "Ministria" zëvendësohet me AAC.

### **Neni 40**

Në nenin 94 dhe 95 të ligjit bazik, fjalët "Ligjin Nr. 2004/17 mbi Mbrojtjen e Konsumatorëve" zëvendësohen me fjalët "Ligjin përkatës për mbrojtjen e konsumatorit".

**Neni 41**

Pas nenit 99 të Ligjit bazik, shtohet neni i ri 99/A me tekstin si në vijim:

**Neni 99/ A  
Dispozitat Kalimtare**

1. Brenda gjashtë (6) muajve, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, AAC harton dhe miraton Rregulloren për organizimin e brendshëm në pajtim me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, pushon mandati i anëtarëve të Bordit.
3. Të punësuarit e AAC-së, vazhdojnë ta kenë statusin e nëpunësit civil edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.
4. Drejtori i Përgjithshëm dhe zv. Drejtori i përgjithshëm i AAC-së, të emëruar sipas Ligjit bazik, vazhdojnë të ushtrojnë mandatin edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Statusi dhe mandati i tij rregullohet me Ligjin përkatës për zyrtarët publikë dhe Ligjin –përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.
5. Në tërë tekstin e Ligjit Nr. 03/l-051 për Aviacionin Civil emërtesa “Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit” zëvendësohet me emërtesën “Ministria përgjegjëse për transport”.
6. Brenda gjashtë (6) muajve, Aktet nënligjore të mbetura sipas Ligjit bazik përgatiten, harmonizohen dhe miratohen nga Ministri.

**Neni 42  
Hyrja në fuqi**

Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 08/L-063  
4 gusht 2022**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-294/2022, datë 22.08.2022 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu**